



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORATI

Nr. 1340 Prot.

Tiranë, më 15.10.2018

UDHËZIM

Nr. 2 datë 15.10.2018

**PËR
REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE NË KUOTAT E PAPLOTËSUARA SIPAS
PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE TË INTEGRUAR TË CIKLIT
TË DYTË NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, VITI AKADEMIK 2018-2019**

Në zbatim të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, Statutit dhe Rregullores së UMT-së, Udhëzimit nr. 18, datë 21.05.2018 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në Institucionet e Arsimit të Lartë për vitin akademik 2018-2019” të MASR, i ndryshuar me Udhëzimin nr.32, datë 5.10.2018 “Për një shtesë në udhëzimin nr.18...”, për procesin e regjistrimeve në kuadër të plotësimit e kuotave të mbetura bosh sipas programeve të studimit,

UDHËZOJ:


1. Kandidatët të cilët nuk janë të regjistruar në një program studimi në raundin e parë apo të dytë, kanë të drejtë të aplikojnë për programet e studimit të UM, në të cilat ka kuota të paplotësuara.

Kërkesat për aplikim dorëzohen pranë zyrës së protokollit në Rektoratin e UMT në datat 15 - 17 Tetor 2018, nga ora 8:00 deri në 16:00.

- 1.1 Kandidatët që kanë qenë aplikantë në raundin e parë dhe të dytë në programet e studimit të UMT, paraqesin kërkesën me shkrim për aplikim dhe deklaratën nr.1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.
- 1.2 Kandidatët që aplikojnë për herë të parë për programet e studimit të UMT, duhet të paraqesin:
 - Kërkesë me shkrim për programin për të cilin aplikon
 - Kopje e diplomës dhe certifikatës së maturës shtetërore (kopje e noterizuar)
 - Deklaratën nr.1, si dhe deklaratën nr.2 bashkëlidhur këtij udhëzimi

2. Komisioni i monitorimit ngritur me Vendim Rektorati nr.7, datë 2.7.2018 “ Për ngritjen e Komisionit të monitorimit dhe grupit teknik të punës për pranimet e kandidatëve që aplikojnë në programet e ciklit të parë dhe të integruar të ciklit të dytë në UMT, për vitin akademik 2018-2019”, shpall renditjen e kandidatëve që kanë paraqitur kërkesë sipas pikës 1, në përputhje me kriteret e miratuara dhe kuotat e mbetura bosh, brenda datës 18 Tetor ora 16.00, në faqen zyrtare si dhe ja shpërndan këto lista fakulteteve.
3. Regjistrimi i kandidatëve pranë sekretarive mësimore, sipas renditjes të shpallur sipas pikës 2, në përputhje me kuotat e mbetura bosh, bëhet në datat 19-20 Tetor ora 09:00-16.00.
4. Procesi i regjistrimit vijon me faza 1 orëshe, duke i dhënë mundësi kandidatit vijues për vazhdimin e procesit nëse kandidati paraardhës nuk paraqitet për regjistrim brenda fazës përkatëse një orëshe.
5. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Komisioni i Monitorimit dhe fakultetet e UMT-së.

REKTORI
Arben GJATA



DEKLARATË Nr. 1

Unë i nënshkruari _____, lindur më _____
emri, atësia, mbiemri

me kartë identiteti/pasaportë nr. _____

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë _____ Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendrën e Shërbimeve Arsimore dhe Qendrën Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar për trajtimin e të dhënave të mia personale, në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre. Autorizoj, gjithashtu, institucionin e arsimit të lartë ku kam aplikuar, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

3. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi dhe jam dakord për sa më sipër.

4. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm, se në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre, duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër, atësi, mbiemër i kandidatit

Emër, atësi, mbiemër i punonjësit të Protokollit

Firma:

Firma:

Vendi: _____

Data: ____ . ____ . _____

DEKLARATË Nr. 2

Unë i nënshkruari _____, lindur më _____
emri, atësia, mbiemri

me kartë identiteti/pasaportë nr. _____

Deklaroj se jam regjistruar në portalin U-Albania, sipas pikës 5, germa A, Kreu III të Udhëzimit nr.18, datë 21.05.2018, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2018-2019", i ndryshuar, si dhe pikës 1 të Udhëzimit të MASR-së nr. 32, datë 05.10.2018, "Për një shtesë në Udhëzimin nr. 18, date 21.05.2018, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në vitin akademik 2018-2019", të ndryshuar".

Emër, atësi, mbiemër i kandidatit

Emër, atësi, mbiemër i punonjësit të Protokollit

Firma:

Firma:

Data: ____ . ____ . _____

Data: ____ . ____ . _____